



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 725/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.10.2018, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Mirëmbajtje Rutine me Performancë rruga Tepelenë – Dorrëz – Qafë Dushk + rruga Sevaster – Kalivac 66.4 km*”, me nr. REF-74000-06-07-2018, me fond limit 23,371,822 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë”.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k.
Rruga e Kavajës, P. nr.29, kulla B, kati 9, A.36, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë
Ish-Zona Industriale, Gjirokastrë

Subjekt i intersuar: Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” sh.p.k.
Rruga nacionale Ballsh – Fier, Zona kadastrale 1143, Nr. Pasurie 186/7, fshati Belishovë, Fier

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt, “Mirëmbajtje Rutine me Performancë rruga Tepelenë – Dorrëz – Qafë Dushk + rruga Sevaster – Kalivac 66.4 km”, me nr. REF-74000-06-07-2018, me fond limit 23.371.822 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 12.07.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--|-----------------------------------|
| 1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral” sh.p.k. & ”Alb Shpresa” sh.p.k. | 15.699.520 lekë, skualifikuar |
| 2. “Shkëlqimi 07” sh.p.k. | 16.000.000 lekë, kualifikuar |
| 3. “Sark” sh.p.k. | 16.796.460 lekë, skualifikuar |
| 4. “Shëndelli” sh.p.k. | 16.857.320 lekë, kualifikuar |
| 5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Balili Konstruksion” sh.p.k. & ”Kupa” sh.p.k. | 17.795.116 lekë, kualifikuar |
| 6. “Be - Is” sh.p.k. | 19.356.120 lekë, skualifikuar |
| 7. “B – 93 II” sh.p.k. | 20.611.120 lekë, kualifikuar |
| 8. “Beqiri” sh.p.k. | 21.003.240 lekë, skualifikuar |
| 9. ”Adem Pojani” person fizik | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 03.08.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral Construction Company” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k., është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik Eral Konstruksion Company, rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit si me poshte:

Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetin teknik “Autobitumatriçe”, në pronësi ose me qira, cope 1, ka paraqitur kontraten e qerase me subjektin GE & CO shpk, nenshkruar me date 05.07.2018, me afat qera 3 vite. Po ky mjet me targe TR4893L, i eshte dhene me qera dhe dy subjekteve te tjera 2 T shpk dhe Sterkaj shpk, per te njejten periudhe kohore, ose qe perfshin kete periudhe, cfare e ben fiktive dhe te pavlefshme kete kontrate.

Ne lidhje me deshmite per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, per kapacitetet teknike “grejder”, në pronësi ose me qira, cope 1 dhe “asfaltoshtruese” në pronësi ose me qira, cope 1 operatori ekonomik Eral Konstruksion shpk ka paraqitur kontraten e qerase date 05.07.2018, nenshkruar me subjektin “Feba shpk”. Po keto mjete me anen e kontrates se qerase date 27.04.2018, i jane dhene subjektit Caushi shpk, per te njejten periudhe ose qe perfshin kete, cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

Per kapacitetin teknik “Fabrike asfaltbetoni (QKL & Leje mjedisore) në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi”, operatori ekonomik Caushi shpk ka paraqitur kontrate furnizimi date 06.06.2018, nenshkruar me subjektin “Feba shpk”. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti “Eral Konstruksion shpk”, rezulton qe subjekti “Feba shpk”, date 06.07.2018, i ka nenshkruar ketij te fundit nje kontrate qeraje, me afat 3 vjecar cfare verteton faktin qe kontratat jane fiktive dhe te pavlefshme.

II.4. Në datën 09.08.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij, duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...]

Në procedurën e tenderit të zhvilluar nga autoriteti juaj shoqëria jonë ka zbatuar me përpikmëri kërkesat e dst pika 2.3.7. ku cilësohet më së miri: “Kur mjetet/pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerasë, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentat e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas përkatësisë. Kontratat e qerasë duhet të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe që mjeti nuk i është dhënë me qera ndonjë subjekti tjetër për këtë periudhë”.

Sipas kushteve të dst shoqëria jonë ka lidhur kontratë noteriale qeraje me shoqërinë “Ge –co” shpk me nr. 444 Rep nr. 194 kol datë 05.07.2018, kontratë kjo me një afat kohor 3 (tre vjeçar) dhe në brendësi të saj citohet se: Qeradhënësi garanton që këto mjete që i jep me qera, janë me dokumentacion të rregullt ligjor, në pronësi të tij dhe në gjendje të mirë teknike dhe gjithashtu nuk janë të dhëna me qera në asnjë subjekt tjetër juridik/fizik. Duam tu vëmë në dije çdo kontratë e lidhur përpara kësaj date është e pavlefshme sepse kontrata që ne kemi nënshkruar në datën 05.07.2018 mbulon të gjithë periudhën e realizimit të kontratës e cila është vetëm për këtë objekt që do të realizohet dhe njëkohësisht nënshkrimi i kësaj kontrate është bërë nga administratori i cili me përgjegjësi të plotë ka pranuar përpara noterit që mjetet e dhëna me qera nuk janë të dhëna në persona të tjerë juridikë/fizikë (pikë kjo e cituar në kontratë tek afati i kontratës). Kontratat e nënshkruara me shoqëritë “Stërkaj” sh.p.k. dhe “2 T” sh.p.k. janë kontrata të cilat mund të përdoren në shumë lloje objktesh duke marrë parasysh kohën e lidhjes së tyre, të cilat bien në kundërshtim me dst ku thuhet se “Makineritë duhet të jenë të angazhuara vetëm në kontratën e sipërcituar dhe në asnjë kontratë tjetër”. Kontrata e nënshkruar midis shoqërisë tonë dhe “Ge-Co” sh.p.k. është kontratë e cila do të përdoret për të gjithë afatin e realizimit të kontratës edhe është posaçërisht vetëm për këtë kontratë duke mos e angazhuar në kontrata të tjera.

- në lidhje me pretendimin tuaj për kontratën e qerasë të nënshkruar me qeradhënësin “Feba” sh.p.k. me nr. 446 rep, nr. 195 kol datë 05.07.2018 për makinerinë grejder dhe asfaltoshtruese autoriteti duhet të shikoj me vëmendje shtojcën e makinerive dhe njëkohësisht dokumentat e paraqitura, sepse shoqëria jonë ka vendosur grejder të cilin e ka në pronësi të saj (fatura nr. 22 datë 30.11.2015) dhe asfaltoshtruese të marrë me qera tek subjekti “Al Asfalt” sh.p.k. që do të thotë, të dyja këto makineri nuk janë të marra me qera tek subjekti “Feba” sh.p.k. (në kundërshtim me arsyen tuaj të skualifikimit).

- Përsa i përket fabrikës së asfaltobetonit, kontrata që ne kemi nënshkruar me këtë subjekt është vazhdim i rilidhjeve të kontratave që ne kemi bërë me shoqërinë “Feba” sh.p.k. Duam tu vëmë në dije që kontrata noteriale e qerasë është për një periudhë kohore 3 (tre) vjeçare dhe për më tepër në hartimin e saj cilësohet mos dhënia me qera në subjekte të tjera juridike / fizike.

Çdo lloj kontrate e bërë mbas kësaj date është jo ligjore për arsye se nuk ka një revokim kontrate me mirëkuptimin e të dy palëve siç shprehet në kontratë, në nenin e Zgjidhjes së mosmarrëveshjes (të kësaj kontrate) që ne kemi paraqitur dhe autoriteti me të drejtë do të bënte skualifikimin e shoqërisë tonë.

Të drejtën e revokimit të kontratës noteriale qeradhënëse midis “Feba” sh.p.k. dhe “Eral Construction Company” sh.p.k. e ka mirëkuptimin midis dy palëve ose në të kundërt Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në nenin 54 pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, parashikohet se:[...]

Në bazë të nenit 54 pika 3 të ligjit të sipërcituar më sipër shoqëria jonë ka zbatuar të gjitha kriteret e dst-së dhe për më tepër duke plotësuar kriterin bazë të përzgjedhjes së fituesit i cili është çmimi më i ulët. Në këtë procedurë makineritë që ne kemi vendosur janë të angazhuara vetëm në këtë procedurë tenderi dhe do të jenë të angazhuara gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve sipas grafikut të dst.

Fakti që jemi oferta më e ulët që konkurrojmë autoriteti nuk mund të skualifikojë një shoqëri ku makineria tip autobitumatrice do ta përdorë 2 (dy) orë në një hark kohor prej 2 (dy) vjetësh.

Përsa më lart kërkojmë rikualifikimin e shoqërisë tonë, pasi jemi në përputje të plotë me kriteret dhe kërkesat e DST dhe njëkohësisht duke plotësuar kriterin bazë të përzgjedhjes së fituesit i cili është çmimi më i ulët.

II.5. Me shkresën nr. 551 prot., datë 14.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën.

Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

[...]

Në lidhje me pretendimin për kapacitetin teknik “Autobitumatrice” theksojmë se operatori ekonomik “Eral Konstruksion Company” shpk ka paraqitur kontratën e qerasë me subjektin “Ge – Co” shpk nënshkruar më datën 05.07.2018 me afat qera 3 vite. Po ky mjet me targë TR4893L, i është dhënë me qera edhe dy subjekteve të tjera: “2T” sh.p.k. dhe “Stërkaj” sh.p.k. me kontratë noteriale të qerasë të datës 23.10.2015 për 5 vjet pra për të njëjtën periudhë kohore ose që përfshin periudhën e zbatimit të kontratës. Përsa i përket pretendimit se qeradhënësi në kontratës e qerasë të datës 07.07.2018 me ankimuesin pranon se nuk ka dhënë me qera në persona të tjerë theksojmë se edhe dy kontratat e tjera të qerasë të datës 23.10.2015 dhe të datës 24.05.2017 i njëjti qeradhënësi në pikën “Detyrimet e qeradhënësit” garanton dhe siguron për një përdorim të lirë dhe të qetë për të gjithë periudhën e kontratës dy qiramarrësit e tjerë “Stërkaj” dhe “2 T” sh.p.k. Gjithashtu në këto dy kontrata të tjera ndalohet dhënia e mjetit për përdorim apo nënqera në persona të tjerë. Fakti që këto kontrata janë paraqitur nga dy operatorët e tjerë ekonomikë “Stërkaj” dhe “2 T” në disa procedura prokurimi kontratash mirëmbajtjesh rrugësh zhvilluar nga autoriteti jonë kontraktor në të njëjtën periudhë tregon se këto kontrata nuk janë zgjidhur

Përsa i përket pretendimit se kapaciteti teknik “Autobitumatrice” përdoret vetëm 2 orë në dy vitet e kontratës nuk qëndron sepse ky kriter është nga kriteret më të rëndësishme dhe thelbësore për realizimin e kontratës. Nga elementët bazë të kontratës janë punimet me materiale asfaltike dhe konkretish me asfaltobeton. Asfaltobetoni nevojitet për kryerjen e punimeve të riparimit të shtresave asfaltike me anë të riveshjes me asfaltobeton, profilimeve me asfaltobeton dhe mbushjes së gropave me asfaltobeton. Theksojmë se në specifikimet teknike punimet me materiale asfaltike janë të një rëndësie primare dhe me afate përfundimi shumë të shpejta (për shumë procese kërkohet që brenda 2 ditëve të përfundojnë riparimet).

Zëri i mbushjes së gropave dhe riparimeve të shtresave asfaltike është një zë në preventiv që paguhet çdo muaj dhe kjo kontratë ka segmentet rrugore të amortizuara që kanë nevojë për mbushje gropash sistematikisht. Kapaciteti teknik "Autobitumatrice" është i nevojshëm sa herë që do të ketë mbushje gropash dhe riparime pjesëore të shtresave asfaltike. Pra mosplotësimi i këtij kriteri ka për pasojë dështimin e operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Në lidhje me pretendimin për kapacitetin teknik "Fabrikë asfaltobetonit (QKL & leje mjedisore) sqarojmë se operatori ekonomik "Eral Konstruksion Company" sh.p.k. ka paraqitur kontratën e qerasë me subjektin "Feba" sh.p.k. të datës 05.07.2018 me afat 3 vjeçar.

Ndërkohë që operatori ekonomik "Çaushti" sh.p.k. ka paraqitur kontratë furnizimi datë 06.06.2018 nënshkruar me subjektin "Feba" sh.p.k. me afat 4 vjeçar. Në këtë kontratë 4 vjeçare me subjektin "Çaushti" shpk parashikohet veç të tjerave në nenin 1/1.4 dhe nenin 5/5.4 edhe zhvendosja dhe instalimi i fabrikës në kantjerët që do të ketë nevojë subjekti "Çaushti" sh.p.k. meqenëse fabrika e asfaltobetonit është e lëvizshme. Gjithashtu për rastet që do të vihet në dispozicion fabrika e asfaltobetonit në kantjerët e tij subjektit "Çaushti" shpk sipas kontratës së lidhur duhet të paguajë një qera të veçantë. Fakti që kjo kontratë është paraqitur nga operatori ekonomik "Çaushti" shpk në disa procedura prokurimi kontratash mirëmbajtje rrugësh zhvilluar nga autoriteti jonë kontraktor në të njëjtën periudhë tregon se kjo kontratë nuk është zgjidhur. Faktet e mësipërme vërtetojnë se këto kontrata janë fiktive dhe të pavlefshme. Pra pretendimet e ankimuesit edhe për këtë kriter nuk qëndrojnë.

II.6. Në datën 23.08.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur pretendimet si më poshtë vijon:

[...] Në procedurën e tenderit të zhvilluar nga autoriteti juaj shoqëria jonë ka zbatuar me përpikmëri kërkesat e dst pika 2.3.7. ku cilësohet më së miri: "Kur mjetet/pajisjet teknike janë me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerasë, dhe bashkëlidhur të gjithë dokumentat e përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas përkatësisë. Kontratat e qerasë duhet të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe që mjeti nuk i është dhënë me qera ndonjë subjekti tjetër për këtë periudhë".

Sipas kushteve të dst shoqëria jonë ka lidhur kontratë noteriale qeraje me shoqërinë "Ge-co" shpk me nr. 444 Rep nr. 194 kol datë 05.07.2018, kontratë kjo me një afat kohor 3 (tre vjeçar) dhe në brendësi të saj citohet se: Qeradhënësi garanton që këto mjete që i jep me qera, janë me dokumentacion të rregullt ligjor, në pronësi të tij dhe në gjendje të mirë teknike dhe gjithashtu nuk janë të dhëna me qera në asnjë subjekt tjetër juridik/fizik. Duam tu vëmë në dije çdo kontratë e lidhur përpara kësaj date është e pavlefshme sepse kontrata që ne kemi nënshkruar në datën 05.07.2018 mbulon të gjithë periudhën e realizimit të kontratës e cila është vetëm për këtë objekt që do të realizohet dhe njëkohësisht nënshkrimi i kësaj kontrate është bërë nga administratori i cili me përgjegjësi të plotë ka pranuar përpara noterit që mjetet e dhëna me qera nuk janë të dhëna në persona të tjerë juridikë/fizikë (pikë kjo e cituar në kontratë tek afati i kontratës). Kontratat e nënshkruara me shoqëritë "Stërkaj" sh.p.k. dhe "2 T" sh.p.k. janë kontrata të cilat mund të përdoren në shumë lloje objektesh duke marrë parasysh kohën e lidhjes së tyre, të cilat bien në kundërshtim me dst ku thuhet se "Makinëritë duhet të jenë të angazhuara vetëm në kontratën e sipërcituar dhe në asnjë kontratë tjetër".

Kontrata e nënshkruar midis shoqërisë tonë dhe “Ge-Co” sh.p.k. është kontratë e cila do të përdoret për të gjithë afatin e realizimit të kontratës edhe është posaçërisht vetëm për këtë kontratë duke mos e angazhuar në kontrata të tjera.

- në lidhje me pretendimin tuaj për kontratën e qerasë të nënshkruar me qeradhënësin “Feba” sh.p.k. me nr. 446 rep, nr. 195 kol datë 05.07.2018 për makinerinë grejder dhe asfaltoshtruese autoriteti duhet të shikoj me vëmendje shtojcën e makinerive dhe njëkohësisht dokumentat e paraqitura, sepse shoqëria jonë ka vendosur grejder të cilin e ka në pronësi të saj (fatura nr. 22 datë 30.11.2015) dhe asfaltoshtruese të marrë me qera tek subjekti “Al Asfalt” sh.p.k. që do të thotë, të dyja këto makineri nuk janë të marra me qera tek subjekti “Feba” sh.p.k. (në kundërshtim me arsyen tuaj të skualifikimit).

- Përsa i përket fabrikës së asfaltobetonit, kontrata që ne kemi nënshkruar me këtë subjekt është vazhdim i rilidhjeve të kontratave që ne kemi bërë me shoqërinë “Feba” sh.p.k. Duam tu vemë në dije që kontrata noteriale e qerasë është për një periudhë kohore 3 (tre) vjeçare dhe për më tepër në hartimin e saj cilësohet mos dhënia me qera në subjekte të tjera juridike / fizike.

Çdo lloj kontrate e bërë mbas kësaj date është jo ligjore për arsye se nuk ka një revokim kontrate me mirëkuptimin e të dy palëve siç shprehet në kontratë, në nenin e Zgjidhjes së mosmarrëveshjes (të kësaj kontrate) që ne kemi paraqitur dhe autoriteti me të drejtë do të bënte skualifikimin e shoqërisë tonë.

Të drejtën e revokimit të kontratës noteriale qeradhënëse midis “Feba” sh.p.k. dhe “Eral Construction Company” sh.p.k. e ka mirëkuptimin midis dy palëve ose në të kundërt Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në nenin 54 pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, parashikohet se:[...]

Në bazë të nenit 54 pika 3 të ligjit të sipërcituar më sipër shoqëria jonë ka zbatuar të gjitha kriteret e dst-së dhe për më tepër duke plotësuar kriterin bazë të përzgjedhjes së fituesit i cili është çmimi më i ulët. Në këtë procedurë makineritë që ne kemi vendosur janë të angazhuara vetëm në këtë procedurë tenderi dhe do të jenë të angazhuara gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve sipas grafikut të dst.

Fakti që jemi oferta më e ulët që konkurrojmë autoriteti nuk mund të skualifikojë një shoqëri ku makineria tip autobitumatrice do ta përdorë 2 (dy) orë në një hark kohor prej 2 (dy) vjetësh.

Përsa më lart kërkojmë rikualifikimin e shoqërisë tonë, pasi jemi në përputje të plotë me kriteret dhe kërkesat e DST dhe njëkohësisht duke plotësuar kriterin bazë të përzgjedhjes së fituesit i cili është çmimi më i ulët.

Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër në datën 14.08.2018 në postën tonë elektronike (email) dërgon shkresën me nr. 551 prot., datë 14.08.2018 për shqyrtimin e pretendimeve tona për tenderin e lartpërmendur.

Në lidhje me arsyetimet e Drejtorisë së Rajonit Jugor Gjirokastër duam të theksojmë se:

Autoriteti kontraktor nuk është i saktë në përgjigjen që kthen për arsye se:

- Duke ja vënë dhe në dukje në formularin e ankesës që shoqëria jonë ka përdorur në këtë procedurë tenderi makineritë grejder të cilën nuk e ka përdorur në procedura të tjera tenderimi (pronësi) fatura nr. 22 dt. 30.11.2015 dhe Asfaltoshtruese (me qera) tek subjekti “Alasfalt” sh.p.k. me kontratë nr. 470 rep, nr. 215 Kol Dt 12.07.2018*

Autoriteti vazhdon dhe kthen përgjigje që shoqëria jonë ka përdorur makineritë asfaltoshtruese, grejder të marra me qera tek subjekti “Feba” sh.p.k.

Këto makineri që ne kemi përdorur përveçse janë vendosur tek grafiku i makinerive dhe të pa angazhuara në procedura të tjera prokurimi dhe njëkohësisht janë shoqëruar me të gjithë dokumentacionin përkatës duke e bërë akoma dhe më të kuptueshme listën e makinerive që shoqëria jonë do të angazhojë në këtë procedurë prokurimi.

Në lidhje me makinerinë Autobitumatriçe (kohëzgjatja e përdorimit të saj është vetëm 2 orë gjatë 2 viteve të kontratës) ju bëjmë me dije se:

- Kontrata e nënshkruar me shoqërinë “Ge – co” sh.p.k. është lidhur më datë 05.07.2018 e cila mbulon të gjithë periudhën e realizimit të objektit të sipërpërmendur dhe gjithashtu është lidhur në një kohë më përpara se kontratat që kanë nënshkruar shoqëritë “Stërkaj” sh.p.k. dhe “2 T” sh.p.k. kontratat e nënshkruara vite më parë e kanë humbur vlefshmërinë e tyre ndërkohë që është lidhur një kontratë e re duke e shoqëruar me deklaratën e zgjidhjes të mirëkuptimit të dy palëve të marrëveshjes së dy palëve duke u bazuar në nenin e “Zgjidhjes së Mosmarrëveshjes” në kontratën e nënshkruar nga të dy palët.
- Në lidhje me fabrikën e asfaltobetonit autoriteti kontraktor hamendëson që kontrata e lidhur me subjektin “Çaushi” sh.p.k. është e pazgjidhur duke mos bërë një verifikim të saktë të saj. Gjithashtu fabrika e asfaltobetonit nuk është një fabrikë imboliare ku të montohet në vendet që do furnizuesi ose qeramarrësi. Nëse do të shikohen më me detaje dokumentacionet e saj vërtetohet që është një fabrikë stacionere dhe jo e lëvizshme. Shoqëria “Feba” sh.p.k. nuk mund të lidhë kontrata furnizimi ose të dhënies me qera për këtë periudhë me subjekte të tjera pasi objekti i saj “Fabrikë prodhim asfaltobetonit” është dhënë me qera për një periudhë 3 (tre) vjeçare me subjektin tonë. Problemet që lindin midis dy subjekteve tona zgjidhen me marrëveshje ose i drejtohen gjykatës dhe deri tani nuk kemi asnjë komunikim zyrtar ose pretendim të ndryshëm midis palëve të lidhura.
- Ju bëjmë me dije se kompania jonë ka kapacitetet mekanike dhe ekonomike për realizimin e një kontrate me cilësi të lartë dhe brenda ofertës ekonomike të ofruar gjë që e ka të dëshmuar në dy vitet paraardhëse në realizimin e kësaj kontrate të këtij objekti duke u çertifikuar nga po ky autoritet kontraktor .

Përsa më lart kërkojmë nga Komisionit i Prokurimit Publik që ankesa e paraqitur nga ana jonë të merret parasysht sepse mendojmë që kemi të bëjmë me një vlerësim jo të saktë nga ana e KVO-së pasi jemi në përputhje të plotë me kriteret dhe kërkesat e DST-së dhe njëkohësisht duke plotësuar kriterin bazë të përzgjedhjes së fituesit i cili është çmimi më i ulët.

II.7. Në datën 10.09.2018, nëpërmjet shkresës me nr.612 prot., datë 04.09.2018, me objekt: “Dërgohet informacion i hollësishëm mbi procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Tepelenë – Dorrëz – Qafë Dushk + rruga Sevaster – Kalivaç 66.4 km”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k. & “Alb Shpresa” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi në lidhje me mjetet, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, pika 2.3. Kapaciteti teknik, pika 2.3.7. dhe 2.3.8., nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar kriteret: “2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. *Per këte duhet të paraqese deshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.*

Kerkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues	në pronësi ose me qira	Copë 2
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Eskavatore fadrome	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Eskavator me Goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Kamioncine	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Fabrike asfaltobetoni (QKL & Leje mjedisore)	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (leje qarkullimi), çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes / cdoganimi në RSH (ose kalimi me regjim të perkohshëm), fotot dhe fatura tatimore perkatëse.*
- *Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale e qerase, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqerohen me kuponin tatimor.*

Kur mjetet / pajisjet teknike jane me qera, duhet të paraqitet kontrata noteriale e qerase, dhe bashkëlidhur te gjithë dokumentet e përshkruar ne paragrafët 1, 2 dhe 3, sipas perkatesise. Kontratat e qerase duhet te përfshijnë te gjithë periudhën e realizimit te kontrates dhe te deklarohet qartësisht nga qeradhensi qe mjete nuk i eshte dhene me qera ndonjë subjekti tjetër per kete periudhe.

Fabrika asfaltobetoni duhet te jete e montuar ne gjendje pune dhe e instaluar ne nje venndodhje jo me larg se 60 km nga objekti (mjafton nga nje pike e rrugeve qe mirembahen nga Kontrata). Ajo duhet te jete e pajisur me QKL dhe leje mjedisore. Ofertuesi duhet te deklaroje vendndodhjen e sakte te fabrikes se asfaltobetonit te montuar (nuk pranohet deklarate levizje impianti), te paraqese planin e vendosjes te fabrikes se asfaltobetonit dhe te paraqese fotografi te fabrikes se asfaltobetonit te montuar ne venndodhjen e deklaruar.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

2.3.8 Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Eral Konstruksion Company" sh.p.k. & "Albshpresa" sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë "Eral Konstruksion Company" sh.p.k. dhe shoqërisë "Albshpresa" sh.p.k., nga ku shoqëria "Eral Konstruksion Company" sh.p.k. merr përsipër të kryejë 94% të vlerave të zërave të punimeve të preventivit, shoqëria "Albshpresa" sh.p.k. ka marrë 6% të vlerave të zërave të punimeve të preventivit.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, konstatohet se nga ana e operatorit ekonomik "Eral Konstruksion Company" është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

1. *Shtojcë Mbi disponimin e makinerive, ku deklarohet, ndër të tjera, si më poshtë:*
 - *Grejder, i deklaruar në pronësi, me dokumentacion faturën tvsh nr.22, datë 30.11.2015, mjet i vitit 1888;*
 - *Asfaltoshtruese, tipi Blaë- Knox-Mk2, fletë doganore R 63742 Dt. 31.10.2009 model PF 45, me qera, nga shoqëria "Al Asfalt" sh.p.k. me kontratë nr. 470 rep, nr. 215 kol, afati 12.07.2018-12.07.2021;*
 - *Autobitumatrice me targë TR4893L, e deklaruar me qera nga shoqëria "Geco" sh.p.k. me nr. 444 rep, nr. 194 kol, afat 05.07.2018-05.07.2021;*
 - *Fabrikë asfaltobetoni, e deklaruar me fletë doganore, me qera nga shoqëria "Feba" sh.p.k. me nr. 446 rep, nr. 195 kol, me afat 05.07.2018 – 05.07.2021;*
2. *Faturë tatimore shitje nr.2, datë 30.11.2015, për mjet grejder; fletë cdoganimi, foto;*
3. *Kontratë qeraje e lidhur ndërmjet shoqërisë "Al Asfalt" sh.p.k. në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë "Eral Konstruksion Company" sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit, në datën 12.07.2018, me nr. 470 rep, nr. 215 kol, me objekt "[...] jep me qera shoqërisë "Eral*

Construksion Company” sh.p.k. me të dhënat e mëposhtme: Asfaltoshtruese, tipi Blaë-Knox Modeli PF45, viti i prodhimit 1973, fletë doganore R63742 Dt. 31.10.2009, me afat kontrate 3 vjeçare duke filluar nga data 12.07.2018-12.07.2021”.

Në nenin ”Afati i Kontratës” është përcaktuar: ”Afati i kontratës do të jetë për një periudhë 3 vjeçare duke filluar nga data 12.07.2018 – 12.07.2021. Qeramarrësi ka të drejtë të bëjë zgjatje të afatit të kontratës nëse do të jetë e nevojshme. Qeradhënësi garanton që ky mjet është me dokumentacion të rregullt ligjor, në pronësi të tij dhe në gjendje të mirë teknike dhe gjithashtu nuk është dhënë me qera në asnjë subjekt tjetër juridik/fizik/invidid”.

Në nenin ”Detyrimet e qeradhënësit” përcaktohet: ”Ta garantojë qiramarrësin nga cdo shqetësim që mund ti vijë nga persona të tretë për probleme pronësie dhe merr me vete përsipër të zgjidhë këto konflikte”.

- fletë cdoganimi; foto;

4. *Kontratë qeraje e lidhur ndërmjet shoqërisë ”Feba” sh.p.k. në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë ”Eral Construksion Company” sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit, në datën 05.07.2018, me nr. 446 rep, nr. 195 kol, me objekt ”[...] fabrikë asfaltobetonit, të fraksionit të inerteve dhe makinerinë e thërrmimit të gurit (gurëthyes) të shoqëruara me leje mjedisore ”Për linjë e fraksionimit të inerteve, linjë e prodhimit të asfaltobetonit”, kodi III.I.B, lëshuar nga QKL me vendndodhje Luzat Tepelenë, të cilat ja jep me qera shoqërisë ”Eral Construksion Company” sh.p.k. me të dhënat e mëposhtme:*

[...] fabrikë asfaltobetonit - lloji pjesë për impiantin Asfalti, fletë doganore R22014 dt.23.11.2006, targa AA413DD; cisternë bitumi (pjesë të linjës së asfaltobetonit) fletë doganore R 23390 Dt. 12.12.2006; bunker inert 3 C (pjesë të linjës së asfaltit, fletë doganore R 23389 Dt 12.12.2006; pjesë për impiant Asfaltobeton (F.In, fletë doganore R 22640 t. 03.12.2006; pjesë linje asfalti (transportier + esikator) fletë doganore R 23104 Dt. 09.12.2006; pjesë të linjës së asfaltit (cisternë bitumi), fletë doganore R 23105, dt. 09.12.2006; pjesë, pajisje mekanike (pjesë për impiant asfalti) fletë doganore R 22012 Dt. 23.11.2006; makineri për thërrmimin e gurit fletë doganore R 19547, dt 13.12.2010; faturë me materialet totale të fabrikës nr.6 , dt. 27.11.2006 (impiant për asfalt, cisternë bitumi, filter këmishe, shkallë spirale, dhoma tharje, kullë përzierëse, mbidozues 3 ndarëse, 2 ndarëse, tubacion aspirimi, tubacion bitumi, shirita transportues, gabinë me impiant elektrik, cisterna vajdjegëse, gjenerator 250 kë, silos për ngarkim, saldaturë me fije).

Në nenin ”Afati i Kontratës” është përcaktuar: ”Afati i kontratës do të jetë për një periudhë 3 vjeçare duke filluar nga data 05.07.2018 – 05.07.2021. Qeramarrësi ka të drejtë të bëjë zgjatje të afatit të kontratës nëse do të jetë e nevojshme. Qeradhënësi garanton që këto mjete dhe fabrika që i jep me qera janë me dokumentacion të rregullt ligjor, në pronësi të tij dhe në gjendje të mirë teknike dhe gjithashtu nuk janë dhënë me qera në asnjë subjekt tjetër juridik/fizik/invidid”.

Në nenin ”Detyrimet e qeradhënësit” përcaktohet: ”Ta garantojë qiramarrësin nga cdo shqetësim që mund ti vijë nga persona të tretë për probleme pronësie dhe merr me vete përsipër të zgjidhë këto konflikte”.

- dokumentacioni përkatës

5. Kontratë qeraje e lidhur ndërmjet shoqërisë "Geco" sh.p.k. në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë "Eral Konstruksion Company" sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit, në datën 05.07.2018, me nr. 444 rep, nr. 194 kol, me objekt "[...] jep me qera shoqërisë "Eral Konstruksion Company" shpk me të dhënat e mëposhtme: autobitumatrice – Targa TR4893L, lloji ATV Fiat,[...], autobitumatrice – Targa TR 6291R, lloji ATV Fiat [...].

Në nenin "Afati i Kontratës" është përcaktuar: "Afati i kontratës do të jetë për një periudhë 3 vjeçare duke filluar nga data 05.07.2018 – 05.07.2021. Qeramarrësi ka të drejtë të bëjë zgjatje të afatit të kontratës nëse do të jetë e nevojshme. Qeradhënësi garanton që këto mjete janë me dokumentacion të rregullt ligjor, në pronësi të tij dhe në gjendje të mirë teknike dhe gjithashtu nuk janë dhënë me qera në asnjë subjekt tjetër juridik/fizik".

Në nenin "Detyrimet e qeradhënësit" përcaktohet: "Ta garantojë qeramarrësin nga cdo shqetësim që mund ti vijë nga persona të tretë për probleme pronësie dhe merr me vete përsipër të zgjidhë këto konflikte".

- dokumentacioni përkatës.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Eral Konstruksion Company" sh.p.k. & "Albshpresa" sh.p.k., në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka paraqitur dokumentacionin përkatës në lidhje me makineritë dhe mjetet që duhen për realizimin e kontratës.

Konkretisht, referuar arsyes së skualifikimit, të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur shtojcën përkatëse për disponimin e mjeteve, ku si më sipër përshkruar, janë deklaruar mjetet që do të vihen në dispozicion në lidhje me këtë procedurë prokurimi, duke u deklaruar lloji i mjetit, mënyra e disponimit (pronësi/qera), si edhe të dhënat e tjera përkatëse, të cilat përputhen secila, sipas deklaramit në këtë shtojcë, me dokumentacionin shoqërues të hedhur në sistemin e prokurimeve elektronike, sipas kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Gjithashtu, në këtë shtojcë, nga ana e operatorit ekonomik ankimues është bërë deklarimi se (citojmë): *”Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë”*.

III.1.7. Nga ana tjetër, referuar dokumentacionit të paraqitur në lidhje me këto mjete dhe konkretisht kontratave të qerave të lidhura ndërmjet operatorit ekonomik “Eral Konstruksion Company” sh.p.k. dhe shoqërive qeradhënëse si më sipër cituar, konstatohet se, në të gjitha kontratat e qerasë (të renditura në pikën III.1.3.), janë të përcaktuara qartësisht të gjithë elementët dhe të dhënat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Konkretisht, në dokumentat e tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar në mënyrë eksplicite që *“[...] Kontratat e qerave duhet të përfshijnë të gjithë periudhën e realizimit të kontratës dhe të deklarohet qartësisht nga qeradhënsi që mjeti nuk i është dhënë me qera ndonjë subjekti tjetër për këtë periudhë”*, kriter ky i plotësuar më së miri nga ana e operatorit ekonomik ankimues, pasi në të gjitha kontratat e sipërcituara është deklaruar se (citojmë): *“Qeradhënësi garanton që këto mjete janë me dokumentacion të rregullt ligjor, në pronësi të tij dhe në gjendje të mirë teknike dhe gjithashtu nuk janë dhënë me qera në asnjë subjekt tjetër juridik/fizik/individ”*. Gjithashtu, në këto kontrata është deklaruar në nenin “Detyrimet e qeradhënësit”: *”Ta garantojë qiramarrësin nga çdo shqetësim që mund të vijë nga persona të tretë për probleme pronësie dhe merr me vete përsipër të zgjidhë këto konflikte”*.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, thjesht e vetëm fakti i evidentuar nga autoriteti kontraktor se ky operator ekonomik ka lidhur kontrata qeraje për të njëjtat mjete me të njëjtat shoqëri në cilësinë e qeradhënësit, të cilët (këta të fundit) kanë lidhur kontrata qeraje me operatorë të tjerë ekonomikë “Stërkaj” sh.p.k., “2 T” sh.p.k., “Çaushi” sh.p.k., është një argument që nuk mund dhe nuk duhet të shbëjë dhe tjetërsojë kontratat e lidhura mes shoqërive qeradhënëse dhe shoqërisë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k., e aq më pak të shërbejë automatikisht si shkak skualifikimi, ndërkohë që faktikisht referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga vetë autoriteti kontraktor, ky i fundit disponon kontratat e qerasë për mjetet, të cilat përmbajnë të gjithë elementët e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor nuk mund të paragjykojë kontratat e qerasë të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik ankimues, përse kohë që ato garantojnë me vullnet të lirë të të dy palëve, që mjetet e dhëna me qera nuk i

janë dhënë askujt tjetër, e madje shkojnë edhe më tej, duke garantuar edhe faktin se, do shqetësim që mund ti vijë qeramarrësit (në rastin konkret shoqërisë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k.) nga persona të tretë për probleme pronësie, probleme këto të cilat do të zgjidhen nga po vetë qeradhënësi, duke garantuar kështu autoritetin kontraktor në lidhje me disponimin në mënyrë të rregullt të gjitha mjeteve të përcaktuara në kontratat përkatëse.

III.1.10. Për më tepër, lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për mjetin grejder dhe asfaltoshtruese, konstatohet se, operatori ekonomik ankimues, ashtu siç edhe ka deklaruar në shtojcën e disponimit të mjeteve, mjetin grejder e ka në pronësi, kurse mjetin asfaltoshtruese e ka marrë me qera nga shoqëria “Al Asfalt” sh.p.k., për të cilat, ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike edhe dokumentacionin përkatës në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, duke e plotësuar kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, pra në lidhje me këto mjete, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se për këto mjete operatori ekonomik ka paraqitur kontratën e qerasë të lidhur me shoqërinë “Feba” sh.p.k., sqarojmë se, operatori ekonomik ankimues, referuar edhe deklaratës së bërë nga po ai vetë në shtojcën mbi disponimin e mjeteve, ka paraqitur kontratën e qerasë të lidhur me shoqërinë “Feba” sh.p.k. për të vërtetuar faktin e disponimit të mjetit fabrikë asfaltbetoni, për të cilën ka paraqitur edhe dokumentacionin bashkëlidhur, pavarësisht se në këtë kontratë janë të listuara ndër të tjera edhe mjetet grejder dhe asfaltoshtruese.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik të vërtetohet se gëzon dhe disponon kapacitetet e duhura në lidhje me mjetet për realizimin me sukses të kontratës, fakt ky i vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, aq më tepër në kushtet kur ky dokumentacion (kontrata e qerasë) është lidhur me shprehje të vullnetit të lirë të dy shoqërive nënshkruese të kontratës e për më tej, duke u dhënë të gjitha garancitë e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit nga ana e shoqërisë qeradhënëse, pasi në këtë kontratë përmbahen të dhëna të mjaftueshme për të arritur qëllimin për të cilin autoriteti kontraktor e ka kërkuar këtë kriter, duke siguruar një panoramë të plotë në lidhje me mjetet dhe pajisjet.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentat e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Sa më sipër analizuar, konstatojmë se, jemi në kushtet kur nga ana e operatorit ekonomik ankimues është plotësuar kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor në lidhje me dokumentacionin për mjetet, pasi, në rastin konkret operatori ekonomik ankimues e disponon atë në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k. & “Albshpresa” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Mirëmbajtje Rutine me Performancë rruga Tepelenë – Dorrëz – Qafë Dushk + rruga Sevaster – Kalivac 66.4 km”, me nr. REF-74000-06-07-2018, me fond limit 23,371,822 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k. & “Albshpresa” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Eral Konstruksion Company” sh.p.k. & “Albshpresa” sh.p.k.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1427 Protokolli

Datë 23.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha